



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U “Nënë Tereza” kërkon të punësojë **2 (dy)** punonjës në pozicionin **Specialist pranë Sektorit të Prokurimeve, në Drejtorinë Juridike, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Arsim i lartë, profili Juridik. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Preferohet të kenë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune të mëparshme, në fushën e prokurimeve;
- Njohuri shumë të mira të kuadrit ligjor në fuqi në përgjithësi e veçanërisht të prokurimeve publike;
- Të kenë njohuri shumë të mira të procedurave administrative;
- Aftësi dhe fleksibilitet në përditësimet e ndryshimeve ligjore;
- Aftësi për të respektuar afatet;
- Të zbatojnë në mënyrë rigoroze detyrat e ngarkuara;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentata në gjuhën shqipe si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV) në gjuhën shqipe ku të jetë edhe adresa e postës elektronike (e-mail)
3. Diploma/t e arsimit të lartë, të noterizuar/a
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Vetëdeklarimi të gjendjes gjyqësore
(link: <https://www.qsut.gov.al/wp-content/uploads/2021/09/formular-vetedeklarimi-per-gjendjen-gjyqesore.pdf>)
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU “Nënë Tereza” duke nisur nga data **22.10.2025 ora 08:00 deri më 05.11.2025 ora 16:30.**

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet nëpërmjet **e-mail**-it në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME